



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

MENAXHIMI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE

INSTITUCIONET NDËRMJETËSE TË INVESTIMIT KAPITULLI 3

Prof. Dr. Ibish Mazreku

MSc. Fisnik Morina, PhD (c)

NENTOR 2017

FONDET E INVESTIMIT (SHOQËRITË E INVESTIMIT APO FONDET E PËRBASHKËTA)

3

- ❑ **Fondet e investimit (Investment funds)** janë institucione financiare që potencialet e tyre financiare i krijojnë në bazë të shitjes së aksioneve qytetarëve. Nëpërmjet blerjes së aksioneve, qytetarët bëhen aksionarë të fondeve të investimit.
- ❑ Fondet e përbashkëta të investimit zakonisht organizohen në formë të shoqërive të investimit.
- ❑ Potencialet e formuara nga shitja e aksioneve investohen në blerjen e aksioneve dhe obligacioneve të shoqërive dhe të obligacioneve të qeverisë në tregjet e kapitalit.

FONDET E INVESTIMIT (SHOQËRITË E INVESTIMIT APO FONDET E PËRBASHKËTA)

4

- ❑ Me rastin e investimit në këto letra me vlerë, aplikohet menaxhmenti i portofolit në aspektin e kompozimit të kohëpaskohshëm dhe rikompozimit të aktivitetit të fondit të investimit.
- ❑ Esenca e kompozimit të aktivitetit të fondit qëndron në sigurimin e përpjesëtimit optimal ndërmjet investimeve në letra me vlerë me afate të gjata ,të cilat sigurojnë një shkallë relativisht më të lartë të rendimenteve, dhe investimeve në letra me vlerë me afate të shkurtra, që i karakterizon një shkallë më e lartë e likuiditetit dhe shitja me e lehtë e tyre në tregjet financiare.

FONDET E INVESTIMIT (SHOQËRITË E INVESTIMIT APO FONDET E PËRBASHKËTA)

5

- ❑ E ardhura neto që e realizojnë fondet e investimit nga dividendët prej aksioneve të blera të shoqërive dhe nga normat e interesit të obligacioneve të shoqërive të qeverisë, pas zbritjes së shpenzimeve, u shpërndahet aksionarëve të fondeve të investimit.
- ❑ Fondet e investimit janë mekanizma ndërmjetës, nëpërmjet të cilëve investitorët individual blejnë dhe mbajnë në portofolin e tyre letra me vlerë të shoqërive dhe të qeverisë në mënyrë të tërthortë.
- ❑ Pra përmes dividendës nga aksionet e fondit të investimit, aksionarët e fondit në realitet realizojnë fitimet nga dividendët dhe normat e interesit në letrat me vlerë të portofolit të fondit.

FONDET E INVESTIMIT (SHOQËRITË E INVESTIMIT APO FONDET E PËRBASHKËTA)

6

- ❑ Dividendët në aksionet që i zotërojnë aksionarët e fondeve të investimit, varen nga norma mesatare e rendimenteve në aktivin e fondit të investimit (dividend në aksionet e blera, plus interesat nga obligacionet e blera, minus shpenzimet e fondit të investimit).
- ❑ Nëse rritet vlera e tregut e aktivit të fondit të investimit, atëherë aksionarët e fondit realizojnë fitime kapitale.
- ❑ Ndërkaq në rastet kur zvogëlohet vlera e tregut e aktivit të fondit të investimit, atëherë aksionarët e fondit të investimit pësojnë humbje kapitale.

Përparësitë që i ofrojnë sektorit të popullsisë

7

- ❑ **Fondet e investimit** luajnë rolin e ndërmjetësve ndërmjet individëve si investitorë, dhe bizneseve e qeverive si emetues të letrave me vlerë. Nëpërmjet fondeve të investimit, individët huazojnë fondet e tyre të kursyera në formë të blerjes së obligacioneve të qeverisë dhe të shoqërive, dhe aksioneve të shoqërive.
- ❑ Fondet e investimit synojnë ta përmirësojnë procesin e blerjes së letrave me vlerë nga ana e individëve.
- ❑ Përparësitë që me këtë rast i ofrojnë sektorit të popullsisë janë :
 1. Diversifikimi i portofolit,
 2. Menaxhmenti profesional i portofolit, dhe
 3. Tregtueshmëria më e mirë e aktivitetit të ri financiar.

Diversifikimi i portofolit

- ❑ Përmes blerjes së aksioneve të fondeve të investimit, investitorët individualë në mënyrë të tërhtortë bëhen bashkëpronarë përpjesëtimorë të portofolit të fondeve të investimit, në të cilin gjendet një masë e madhe e letrave të llojllojshme me vlerë.
- ❑ Pa ndërmjetësimin e fondeve të investimit, investitorët individual nuk do të mund të bënin diversifikimin e riskut të portofolit, ngase nuk disponojnë kapitale të mjaftueshme për investime në lloje të ndryshme të letrave me vlerë.

Menaxhmenti profesional i portofolit

- ❑ Përparësia tjetër në fondet e investimit ua ofrojnë investitorëve individual qëndron tek e dhëna që me rastin e blerjes së aksioneve të fondeve të investimit, investitorët individual njëherësh blejnë edhe aftësinë profesionale të menaxherëve të fondit, të cilët janë përgjegjës për seleksionimin e letrave me vlerë që fillimisht hyjnë në portofolin e fondit investues, si dhe për letrat me vlerë që blihen dhe shiten në periudhat e mëvonshme në tregjet kapitale, me qëllim të krijimit të strukturës optimale të portofolit,.
- ❑ Pra investitorët individual nëpërmjet blerjes së aksioneve të fondit të investimit, blejnë njëkohësisht edhe diturinë edhe aftësinë profesionale të menaxherëve të fondeve të investimit.

Tregtueshmëria më e mirë e aktivit të ri financiar

10

- ❑ Investitorët individual kanë interes të veçantë që të blejnë aksione të fondeve të investimit edhe për shkak se supozohet se aktivi i ri financiar mund të shitblihet më lehtë në tregje se sa letrat me vlerë të blera më herët.
- ❑ Në këtë aspekt ka një dallim rrënjësor ndërmjet tregutreshmërisë së aksioneve të fondeve të investimit të tipit të hapur dhe aksioneve të fondeve të investimit të tipit të mbyllur.

Tipat kryesorë të fondeve të investimit

- ❑ **Fondet e investimit të tipit të hapur** (open-end mutual funds në terminologjinë amerikane, apo unit trusts në terminologjinë britanike), karakterizohen nga aftësia e tyre dhe mundësia që kanë që në çdo kohë t'i blejnë apo t'i shesin aksionet e tyre nga mbajtësit.
- ❑ Të gjitha këto transaksione investitorët individual i kryejnë drejtpërdrejtë përmes kontrakteve me fondin përkatës të investimit.

Tipat kryesorë të fondeve të investimit

- ❑ **Fondet e investimit të tipit të mbyllur** (closed-end mutual funds, në terminologjinë amerikane, apo investment trusts në terminologjinë britanike), emetojnë kontingjente fikse të aksioneve të tyre, shitjen initiale të të cilave e kryejnë në tregjet parësore të aksioneve, nëpërmjet ofertës publike (public stock offerings).
- ❑ Fondet e tipit të mbyllur nuk i blejnë aksionet e veta të emetuara dhe të shitura nga mbajtësit e tyre, që do të thotë se fondet e investimit të tipit të mbyllur veprojnë njësoj sikursë edhe shoqëritë aksionare në ekonominë reale, të cilat po ashtu nuk i blejnë aksionet e tyre nga zotëruesit, por ato mund të shitblihen vetëm në tregjet financiare, përkatësisht në bursat e letrave me vlerë dhe në tregjet e hapura financiare.

Fondet investuese të specializuara

- Në ekonomitë e zhvilluara me treg, fondet e investimit zakonisht janë të specializuara sipas qëllimeve konkrete që synojnë ti sendërtojnë. Nga ky aspekt mund të themi se si sistematizim i përgjithshëm i fondeve të investimit të cilat janë :
 1. Fondet e investimit të cilat investojnë në blerjen e aksioneve (stock funds);
 2. Fondet e investimit të cilat investojnë në blerjen e obligacioneve (time bond funds) dhe
 3. Fondet e investimit të cilat investojnë në instrumente të tregut të parasë (money market mutual funds).

Shoqëritë e financimit

- ❑ Shoqëritë e financimit i krijojnë fondet e tyre financiare kryesisht përmes emetimit të aksioneve në tregjet e kapitalit, përmes emetimit të letrave komerciale në tregjet e parasë, dhe tërheqjes së fondeve të konsiderueshme financiare në formë të huave nga bankat komerciale.
- ❑ Investimin e potencialeve të tyre financiare shoqëritë financimit e bëjnë në formë të kredive konsumatore qytetarëve, kredive për financimin e shitjes së mallrave me kredi, që u akordohen shoqërive prodhuese dhe tregtare, dhe kredive për pajisje dhe instalime të reja në shoqëritë industriale dhe tregtare.

Shoqëritë e financimit

- ❑ Është i përhapur në veçanti lloji i kredive shoqërive industriale dhe tregtare për instalimin e pajisjeve të reja në bazë të lizingut.
- ❑ Shoqëritë e financimit janë institucione financiare kreditore, por jo edhe depozitare.
- ❑ Tipari kryesor i tyre është se ato marrin hua në shuma të mëdha me një normë të madhe interesi.
- ❑ Ato dallojnë nga bankat që zakonisht pranojnë depozita të vogla dhe japin hua në shuma të mëdha.
- ❑ Karakteristikë tjetër në dallim me bankat është se këto shoqëri janë shumë pak të rregulluara nga entet shtetërore rregulluese.

Llojet e shoqërive të financimit

16

- ❑ Varësisht nga segmenti i aktivitetit të shoqërive të financimit , ato klasifikohen në lloje të ndryshme.
- ❑ Në përgjithësi dallojmë tre tipa të shoqërive të financimit :
 1. Shoqëri financimi të shitjeve,
 2. Shoqëri financimi të konsumatorit, dhe
 3. Shoqëri financimi të biznesit.

Llojet e shoqërive të financimit

- ❑ **Shoqëri financimi të shitjeve** janë ato të cilat japin hua konsumatore për të blerë artikuj të ndryshëm nga firma të ndryshme tregtare. Ato janë konkurrenca të bankave për huat konsumatore sepse këto të fundit mund të merren më shpejt dhe me lehtë për shkak të vendosjes së tyre pranë vendit ku blihet malli.
- ❑ **Shoqëri financimi të konsumatorëve** janë ato të cilat u japin hua konsumatorëve për të blerë mallrat e veçanta si mobile apo pajisje shtëpiake, për rikonstruksionin e shtëpisë ose për të paguar borxhe të vogla.
- ❑ **Shoqëri financimi të biznesit** janë ato të cilat japin hua specializuar biznesëve duke u blerë atyre me skonto llogari të paarkëtuara. Ky aktivitet njihet me emrin factoring.

Fondet e përbashkëta të tregut të parasë

- ❑ **Fondet e përbashkëta të tregut të parasë** (Money Market Mutual Funds), janë shoqëri investimi të cilat sigurojnë fondet e tyre financiare përmes shitjes së letrave me vlerë me afat të shkurtër.
- ❑ Ato janë ndërmjetësit financiar më të rëndësishëm.
- ❑ Fondet u ofrojnë zotëruesve të kursimeve normat e interesit të tregut të parasë dhe sigurinë e shumës së investuar.
- ❑ Investitorët mund të tërheqin paranë e investuar në fondet e përbashkëta të tregut të parasë sipas dëshirës (fondet riblejnë aksionet e veta).

Fondet e përbashkëta të tregut të parasë

- ❑ Rritja e shpejtë e fondeve të përbashkëta të tregut të parasë ishte rezultat i legjislacionit të bankave komerciale dhe institucioneve të tjera depozituese, sipas të cilit, të gjitha ato ishin të detyruara sa i përket normës së interesit që mund tu paguanin depozituesve.
- ❑ Meqë kur u rritën normat e interesit , bankat nuk mund tu paguanin depozituesve të tyre norma më të larta interesi sesa ajo ishte përcaktuar me legjislacionin mbi institucionet depozitare, fondet e përbashkëta të tregut të parasë iu ofruan zotëruesve të kursimeve norma interesi më të larta, sepse ato nuk ishin subject i detyrimit të legjislacionit në fjalë.

Fondet e përbashkëta të tregut të parasë

- ❑ Kështu fondet financiare filluan të lëvizin nga institucionet e ndryshme depozituese tek fondet e përbashkëta të tregut të parasë.
- ❑ Institucionet depozituese mund të emetojnë tani llogari të tregut të parasë që ofrojnë privilegje të kufizuara dhe paguajnë norma interesi, që janë konkurruese me normat e interesit që paguajnë fondet e përbashkëta të parasë.

PËRFUNDIMI I KAPITULLIT TË III-të

